

Prishtinë, 16 korrik 2015
Kodi i ZRRE-së: V_750_2015

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.9, Nenin 25, Nenit 46/6 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 3 nënparagrafi 5 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr.03/L-2001);
- Dispozitave të Nenit 18 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, lëshuar KEDS sh.a;
- Kërkesën për aprovim të Programit të Pajtueshmërisë së KEDS sh.a. të datës 01.07.2015;

në seancën e mbajtur me datë 16 korrik 2015, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Arsyetim

- o Në përputhje me obligimet Ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, KEDS sh.a, me datë 20.02.2015 ka dërguar në ZRRE draftin fillestar të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
 - o Pas vlerësimit të këtij projekt Programi, ZRRE me datë 05.03.2015 ka dërguar vërejtjet dhe komentet e saja në te.
 - o Me datë 01.07.2015 KEDS sh.a, ka dërguar në ZRRE draftin final të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, me përgjigjet në vërejtjet e ZRRE të bëra me datë 05.03.2015, duke kërkuar aprovimin e tij nga ZRRE.
 - o ZRRE duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë, dhe në përputhje me përgjegjësitë e dhëna me dispozitave ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.**




III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


IV. Versioni i aprovuar i Programit të Pajtueshmërisë do të publikohet nga KEDS sh.a. brenda 5 ditë pune, pas publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkangjitur: Programi i Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, KEDS sh.a.

Bordi i ZRRE-së:



Enver Halimi, kryesues


Merita Kostari, anëtar


Krenar Bujupi, anëtar



Ndërtesa e Elektrokosovës *Elektrokosova Building*
Bulevardi Bill Clinton nr.3 *Bill Clinton Bulevard no.3*
Prishtinë 10000 *Prishtina 10 000*
Republika e Kosovës *Republic of Kosovo*



Programi i Pajtueshmërisë i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes


("Programi i Pajtueshmërisë")

Korrik, 2015



Permbajtja

Korniza ligjore për lëshimin e Programit të Pajtueshmërisë	3
Objekti i Programit të Pajtueshmërisë.....	3
Zyrtari i Pajtueshmërisë me Rregullatorin	3
Detyrat dhe të drejtat e punëtorëve për qëllimet e Programit të Pajtueshmërisë	4
Realizimi i Programit të Pajtueshmërisë	4
Proceset e brendshme	4
Informatat e ndjeshme komerciale	5
<i>Informimi i Publikut</i>	5
<i>Informacioni i kontraktuar</i>	6
<i>Informacioni konfidencial</i>	6
Zbatimi i Programit të Pajtueshmërisë.....	7
Raporti vjetor mbi masat e miratuara për zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë	7
Vlefshmëria dhe Forca e Programit të Pajtueshmërisë.....	8



Korniza ligjore për lëshimin e Programit të Pajtueshmërisë

Operatori i Sistemit të shpërndarjes ka krijuar Programin e Pajtueshmërisë, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr 03/L-201 i cili obligon Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për të krijuar atë dhe Zyrën e Rregullatorit të Energjisë të miratohet atë.

Objekti i Programit të Pajtueshmërisë


Në kuadrin e Programit të Pajtueshmërisë (PP), Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcakton në veçanti:

- Zyrtarin e Pajtueshmërisë (ZP) për monitorimin e PP dhe raportimin tek ZRRE siç kërkohet me nenin 18 të Licencës së Shpërndarjes dhe Doracakut të Raportimit të ZRRE-së;
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e punonjësve të operatorit të sistemit të shpërndarjes për të përmbushur objektivin e Programit të Pajtueshmërisë;
- Masat për eliminimin e sjelljeve diskriminuese në raport me pjesëmarrësit e tjerë në tregun e energjisë elektrike;

Zyrtari i Pajtueshmërisë me Rregullatorin

Bordi Ekzekutiv i KEDS-it ka caktuar një Zyrtar të Pajtueshmërisë (ZP) me efekt nga korriku i vitit 2015. ZP është përgjegjës për të siguruar pajtueshmërinë, si dhe për dorëzimin e raporteve të pajtueshmërisë tek ZRRE bazuar në Doracakun e Raportit të ZRRE-së. ZP do të monitorojë respektimin e PP dhe respektojnë detyrimet ligjore që përmbahen në të. ZP është përgjegjës për çdo përshtatje ose ndryshim i PP me procedurën e rënë dakord me ZRRE. Çdo rishikim i PP do t'i nënshtrohet aprovimit paraprak nga ZRRE-ja.

ZP mund të merr pjesë në të gjitha mbledhjet e menaxhmentit ose organeve administrative të KEDS-it, të bordit të drejtorëve dhe në mbledhje të aksionarëve, dhe do të jetë i pranishëm në të gjitha takimet që trajtojnë çështjet që lidhen me kushtet për organizimin, dhe qasjet në rrjet, në veçanti në lidhje me tarifën, procedurat e qasjes së palës së tretë, alokimit të kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kongestionit, transparencës, balancimit dhe legjislacionet sekondare. ZP do të hartojë masa për të kufizuar ose, kur është e nevojshme, ndaluar qasjen e punëtorëve në sistemet e KEDS-it për regjistrimin, përpunimin ose ruajtjen e të dhënave të ndjeshme.



ZP do të ketë qasje në të gjitha informatat e nevojshme të KEDS-it në mënyrë që të përmbushë detyrat e tij të tilla si dosje, dokumente dhe sistemeve elektronike të përpunimit të të dhënave. Duke filluar nga viti 2015, ZP do të dorëzojë një raport vjetor bordit të drejtorëve të KEDS-it dhe në ZRRE mbi masat e marra për zbatimin e PP; duke përfshirë të gjitha shkeljet e ndodhura dhe masat disiplinore që janë marrë.

Detyrat dhe të drejtat e punëtorëve për qëllimet e Programit të Pajtushmërisë

Të gjithë punonjësit duhet të jenë të familjarizuar me PP me anë të një programi rregullativ të trajnimit të pajtushmërisë. Punonjësit duhet të konfirmojnë përkushtimin e tyre ndaj PP duke nënshkruar një deklaratë mbi përkushtimin me anë të së cilës ata po ashtu do të informohen edhe me shkrim se çdo shkelje e PP do të rezultojë në veprime disiplinore, përfshirë zhvendosjen punëtorëve dhe/ose shkarkimin nga puna. KEDS do të sigurojë dëshminë në ZRRE të këtyre deklaratave të nënshkuara të angazhimit para fillimi të Fazës së parë të Regjistrimit. KEDS po ashtu do të kryejë trajnime specifike dhe të rregullta në PP për të gjithë punëtorët dhe sidomos për punonjësit e rinj si pjesë e programit hyrës. Njohja me PP do t'i mundësohet çdo anëtarit të rinj të bordit të KEDS. Të gjithë punonjësit janë të detyruar për të mbështetur në mënyrë aktive ZP në detyrat e tij dhe të sigurojnë informacionin e kërkuar plotësisht dhe besnikërisht. Punonjësit do të sjellin në vëmendjen e menjëhershme të ZP ndonjë shkelje të dyshimtë të PP.

Realizimi i Programit të Pajtushmërisë


Programi i Pajtushmërisë realizohet vazhdimisht duke miratuar një sërë masash të veçanta të kategorive të mëposhtme:

- Modifikimi i proceseve të brendshme
- Përcaktimi i rregullave për të lejuar qasje në informatat e ndjeshme komerciale
- Të ndryshme.

Të gjitha masat janë duke u zbatuar në përputhje me rregullat ligjore përgjithësisht të detyrueshme të Republikës së Kosovës, në veçanti, në përputhje me Ligjin e Energjisë, zbatimin e rregulloreve të Ligjit Energjisë dhe në përputhje me Rregullat për operatorin e sistemit të shpërndarjes (sektori i energjisë elektrike).

Proceset e brendshme

Programi i Pajtushmërisë përcakton proceset e brendshme të operatorit të sistemit të shpërndarjes, të cilat mund (nga veprimet e operimit të Sistemit të shpërndarjes) të përmirësojnë pozicionin e një pjesëmarrësi të caktuar në treg në dëm të një tjetri, në mënyrë të veçantë në lidhje me qasjen në sistemin e shpërndarjes dhe shfrytëzimit të shërbimeve të



operatorit të sistemit të shpërndarjes. Këto procese janë të analizuar, monitorohen vazhdimisht dhe janë miratuar masat për parandalimin e trajtimeve preferenciale, nëse është e nevojshme.

Në vijim është një listë e grupeve të prekura të proceseve të brendshme ku është zbatuar plotësisht qasja jo-diskriminuese:

- Qendra e Thirrjeve
- Faturimi dhe përkujtesat e pagesës
- Ndërprerja ose reduktimi i furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike
- Ndërprerja ose reduktimi i furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike – problemet teknike dhe operative
- Kyqja e furnizuesit
- Komunikimi me konsumatorët
- Shkelja e kushteve kontraktuale të shpërndarjes
- Lidhja

Informatat e ndjeshme komerciale

Operatori i sistemit të shpërndarjes ka vendosur rregullat për lejimin e qasjes në informata për pjesëmarrësit në tregjet e energjisë elektrike në një mënyrë jo-diskriminuese. Aplikimi i rregullave monitorohet dhe masat për të lejuar qasjen në informata për pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike në një mënyrë jo-diskriminuese adaptohen sa herë që është e nevojshme.


Çështja e temës së Programit të Pajtueshmërisë është komercialisht informacioni i ndjeshëm i cili është në dispozicion të operatorit të sistemit të shpërndarjes drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes disa subjekteve të tjera, ose të cilat operatori i gjeneron nga aktivitetet e tij dhe që, nëse i ipen vetëm disa pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike, do tu jepte atyre një avantazh konkurrues. Informata komercialisht e ndjeshme është e ndarë në tre grupe me metoda të ndryshme për sigurimin e qasjes jodiskriminues dhe shthurjen e informacionit:

- Informimi i publikut
- Informacioni kontraktual
- Informacioni konfidencial.

Në rast të informacionit komercialisht të ndjeshëm, ofrohet përpunimi i tij i plotë jo-diskriminues dhe lirimi për pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike.

Informimi i Publikut

Informimi i publikut nënkupton çdo informacion që është në dispozicion për çdo person të tretë dhe i botuar në një mënyrë që mundëson qasje të largët.



- Zhvillimi i parashikuar i sistemit të shpërndarjes
- Përshkrimi i sistemit të furnizimit me energji elektrike
- Rregullat për operimin e sistemit të shpërndarjes
- Format e aplikimit për kyçje dhe ofrimin e linjës së shpërndarjes
- Kushtet komerciale për sigurimin linjës së shpërndarjes
- Informacione të përgjithshme mbi funksionimin e sistemit të shpërndarjes
- Treguesit e cilësisë së Programit të Pajtueshmërisë për ofrimin e energjisë elektrike dhe shërbimeve dhe Raportin Vjetor mbi masat e miratuara për zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë në vitin paraprak
- Informatat kontaktuese të auditorit të Programit
- Informacione të mëtejshme lëshuar nga operatori i sistemit të shpërndarjes në një mënyrë që lejon qasje nga distanca.

Informacioni i kontraktuar


Me informacione kontraktuale ne kuptojmë informacionin e dhënë ose që pason nga kontrata mes operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe një partneri kontraktual. Ky informacion mund ti zbulohet vetëm pales kontraktuese përkatëse, në bazë të kontratës ose te një organ i administratës shtetërore në bazë të një kërkesë ligjore; për një palë të tretë një informacion i tillë konsiderohet si konfidencial.

- Partnerit të biznesit të mbajtësit të licencës së shpërndarjes
- Pikës së furnizimit
- Dështimet e Shpërndarjes dhe rregullimet e tyre
- Ankesat lidhur me aktivitetet e mbajtësit të licensës dhe distribucionit
- Vlera e shpërndarjes së energjisë elektrike tek një konsumator specifik
- Klasa e tipit të diagrameve të përditshme / vlerën e konsumit të planifikuar.

Informacioni konfidencial

Çdo informacion mbi sistemin e shpërndarjes i ndikuar nga Programi i Pajtueshmërisë që nuk është publik ose kontraktual konsiderohet si konfidenciale.

Të gjitha kontratat e punësimit, kontratat për lirim të zyrës nga detyra dhe marrëveshjeve të konfidencialitetit të ekzekutuara në mes të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe të punonjësve të saj dhe / ose anëtarëve të organit të saj ligjor apo ndonjë kontratë tjetër e ngjashme duhet të përfshijë një nen në lidhje me konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm komercial nga pika e kërkesave të Programit të Pajtueshmërisë. Në rast të kontratave të punësimit, detyrimi i konfidencialitetit mbetet në fuqi për tërë mandatin, si dhe pas përfundimit



të punësimit. Në rast të kontratave tjera nga kontratat e punës, detyrimi i konfidencialitetit mbetet në fuqi për periudhën kohore të ushtrimit të aktiviteteve në fjalë për operatorin e sistemit të shpërndarjes, si dhe pas përfundimit të tyre.

Nëse partnerët kontraktual vijnë në kontakt me informacionin e ndjeshëm komercial gjatë përmbushjes së urdhëresave që u caktohen atyre nga operatori i sistemit të shpërndarjes, operatori i sistemit të shpërndarjes kërkon që një dispozitë konfidencialitetit në lidhje me një informacion të tillë të përfshihet në kontratat përkatëse.

Nëse pala në kontratën e bërë me operatorin e sistemit të shpërndarjes shkel detyrimin e konfidencialitetit lidhur me informacionin e ndjeshëm komercial, operatori i sistemit të shpërndarjes do të vazhdoj, në varësi të karakterit të marrëdhënies kontraktuale, në përputhje me kontratën përkatëse dhe rregulloret ligjore përgjithësisht detyruese që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe / ose marrëdhëniet komerciale detyrim.


Zbatimi i Programit të Pajtueshmërisë

Informacioni në lidhje me Programin e Pajtueshmërisë duhet tu jepet të gjithë anëtarëve të trupit ligjor, anëtarëve të bordit mbikëqyrës, nëpunësve konfidencial (nëse ka të emëruar) dhe të gjithë të punësuarve. Trajnimi i të gjithë punonjësve në rast të ndryshimeve të Programit të Pajtueshmërisë është i organizuar. Një trajnim i tillë është gjithashtu një pjesë integrale e procedurave orientuese për punëtorët e rinj. Njohja me Programin e Pajtueshmërisë gjithashtu do të pasoj kur të jenë zgjedhur anëtarët e rinj të bordit, dhe në rast të emërimit të ndonjë nëpunësi të ri konfidencial.

Raporti vjetor mbi masat e miratuara për zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë

ZP do të shkruajë një raport vjetor mbi masat e marra në vitin paraprak për zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë. Raporti vjetor do të rishikohet nga menaxhmenti i KEDS-it, dhe do të aprovohet nga bordi ekzekutiv i KEDS-it, e më pastaj duhet t'i dorëzohet Zyrës së Rregullatorit për Energji deri më 30 prill i vitit relevant. Në të njëjtën kohë, ai do ta publikojë atë në një mënyrë që mundëson qasje nga distanca. ZP është i obliguar të dorëzoj raportin e pajtueshmërisë tek bordi ekzekutiv i KEDS-it deri në fund të muajit janar të vitit relevant. Bordi ekzekutiv duhet të aprovoj raportin jo më larg se fundi i muajit shkurt i vitit relevant.

Sidoqoftë, ZP duhet t'i raportoj ZRRE-së për çdo mos-pajtueshmëri, ashtu siç është definuar në Doracakun e Raportimit të ZRRE-së, pavarësisht kohës së raportimit vjetor.



Vlefshmëria dhe Forca e Programit të Pajtueshmërisë

Programi i Pajtueshmërisë do të jetë i vlefshëm dhe në fuqi kur të është aprovuar nga Bordi i ZRRE-së. Programi i Pajtueshmërisë do të mbetet i vlefshëm dhe në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar.